



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

LIGJ

Nr. 55/2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008,
“PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e deputetit Ilir Beqaj,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 4 “Niveli i taksave kombëtare” bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 8, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në rastet kur artikujt që importohen në kapitullin 39, të NKM-së, pjesa joplastike zë më shumë se 51 për qind të masës së përgjithshme, kjo taksë zbatohet vetëm për pjesën e masës së plastikës.”.

2. Në pikën 8/1, fjalët 25 lekë/kg” zëvendësohen me fjalët “10 lekë/kg”.

3. Pika 8.5 riformulohet si më poshtë:

“8.5. Për ambalazhet plastike/qelqi, lëndët e para, si dhe për materialet/artikujt prej plastike, të cilat eksportohen dhe për të cilat taksa është paguar në momentin e importit/prodhimit të tyre, administrata doganore rimbursion shumën e taksës së paguar. Rimbursimi bëhet sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.”.

Neni 2

Në nenin 9 “Përjashtime nga pagimi i taksave kombëtare”, në pikën 4, pas shkronjës “d” shtohen shkronjat “dh”, “e”, “ë” dhe “f” me këtë përmbajtje:

“dh) lëndët e para në forma primare apo artikujt e tjerë të importuar dhe që klasifikohen në kapitullin 39, të NKM-së, të cilat përdoren si plotësues teknologjik, lëndë të para aditive (agregate lidhëse), apo si material për prodhimin e produkteve që nuk kategorizohen si artikuj plastikë. Taksa për lëndët e para në forma primare apo artikujt e tjerë të importuar do të aplikohet vetëm nëse materialet/artikujt e prodhuar nga këto lëndë të para janë subjekt i llogaritjes së taksës në rast se këto materiale/artikuj do të importohen;

e) lëndët e para në forma primare për prodhimin e polisterolit (EPS *expanded polysterene*), importimi i paneleve, pllakave të polistirenit (XPS *extruder polystyrene*), si dhe profileve PVC për prodhimin e dyerve dhe dritareve, sipas kapitullit 39, të NKM-së, artikuj të cilët përdoren në industrinë e ndërtimit në funksion të efijencës së energjisë;

ë) lëndët e para në forma primare për prodhimin e sfungjerëve, si dhe importimi i materialeve/artikujve, sipas kapitullit 39, të NKM-së, që përdoren në industrinë e prodhimit të mobilieve;

f) lëndët e para në forma primare me përmbajtje proteinike të forta apo materialet celuzoike, sipas kapitullit 39, të NKM-së, të cilat përdoren në industrinë e prodhimit të sallameve.

Kodet e detajuara të artikujve në kapitullin 39, të NKM-së, që përjashtohen nga taksa, sipas pikave “dh”, “e”, “ë” dhe “f” më sipër, përcaktohen në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 18.7.2019